



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Kontabiliteti Financiar
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Maj 2018

Kontabiliteti Financiar

- Viti II-të, Semestri IV
- Departamenti : KF
- Statusi i lëndes : Obligative
- Javët mësimore: 15 [4 orë ligjerata, 8 orë ushtrime(4 grupe)]
- Mësimdhënëse: Prof.Ass.Dr. Fitim Deari
- Asistent: MSc.Valdrin Misiri
- Orari i ushtrimeve: E hene (G4 – ora 09:45 - 11:15 E4)
- (G3 – ora 13:15 - 14:45 CI)
- (G2 – ora 15:00 - 16:30 CI)
- Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 11:30 - 13:00 CI)

- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
- Website: www.unhz.weebly.com



PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE

Metoda Indirekte

Pasqyra e rrjedhes se parase – SNK 7

- Pasqyra e rrjedhave te keshit eshte nje pasqyre financiare bazike, e cila raporton hyrjet dhe daljet e keshit te firmes gjate nje periudhe fiskale.
- Roli dhe rendesia e saj behet edhe me e madhe viteve te fundit per shkak se te tri pasqyrat bazike ofrojne informacion te kufizuar, lidhur me rrjedhat e keshit te firmes

Pasqyra e rrjedhes se parase – SNK 7

- Pasqyra e rrjedhave te keshit raporton efektet e aktiviteteteve operative, investuese dhe financiare te ndermarrjes.
- Kjo pasqyre pergatitet nga te dhenat e prezantuara ne bilancin e gjendjes dhe ne pasqyren e te ardhurave. Me fjale te tjera te dhenat e integruara ne pasqyrat financiare, transformohen ne menyre te vecante, ashtu qe perdoren salldot fillestare dhe perfundimtare te kategorive homogjene nga bilanci dhe pasqyra e te ardhurave per periudhen e caktuar fiskale

Pasqyra e rrjedhes se parase – SNK 7

- Pra, pasqyra e rrjedhes se parase, e pergatitur ne kete menyre, siguron informacione lidhur me hyrjet dhe daljet e rrjedhave te keshit per te gjitha aktivitetet operuese, investuese dhe financiare.

Qellimet dhe perdoruesit e pasqyres se rrjedhes se parase

- Qellimi kryesor i pasqyres se rrjedhave te keshit padyshim eshte sigurimi i informacionit per arketimet dhe pagesat e keshit te firmes gjate nje periudhe fiskale.
- Qellimi i dyte i kesaj pasqyre konsiston ne procesimin e informacionit lidhur me rrjedhat e keshit prej aktiviteteteve operuese, investuese dhe financuese
- Nepermjet kesaj pasqyre, menaxhmenti, investitoret, kreditorët dhe perdoruesit tjere, mund ta vleresojne poziten financiare te kompanise nga shume aspekte.

Metoda direkte dhe indirekte

- Raportimi i rrjedhave te parase, prej aktiviteteve operuese brenda pasqyres se rrjedhes se parase, behet nepermjet dy metodave:
 - a) Medota indirekte
 - b) Metoda direkte

Dallimi...

- Rrjedhat e parase, prej aktiviteteve investuese dhe aktiviteteve financuese, raportohen ne menyre te njejte ne te dy metodat. I vetmi dallim ekziston ne prezentimin e rrjedhave te parase se gatshme prej aktiviteteve operuese.

Metoda indirekte

- Metoda indirekte rrjedhat e keshit, prej aktiviteteve operuese, i strukturon ne ate menyre, qe netofitimi i raportuar, ne pasqyren e te ardhurave mbi bazen akruale, te harmonizohett me netorrjedhat e parase se gatshme prej aktiviteteve operuese.
- Me fjale te tjera, metoda indirekte netofitmin e pasqyres se te ardhurave, nga baza akruale, e konverton ne bazen e keshit.

Metoda indirekte

- Pikenisje e pergatitjes se seksionit te rrjedhave te parase se gatshme prej aktiviteteve operuese, ne metoden indirekte eshte neto fitimi i periudhes kontabel.
- Netofitimi i periudhes per tu konvertuar ne rrjedhat e parase sipas aktivitetit operativ, percillet me veprime rregulluese.

Aktiviteti operativ – Metoda indirekte

Fitimi para tatimit

+ Shpenzimet e interesit

= Fitimi para interesit dhe tatimit(EBIT)

+ Shpenzimet e zhvleresimit

+ Humbja kapitale

- Fitimi kapital

(Rritja) Zvogelimi ne stoqe

(Rritja) Zvogelimi ne LL/A

(Rritja) Zvogelimi ne parapagime

Rritja (Zvogelimi) ne LL/P

Paraja e gatshme nga operacionet

- Interesi i paguar

- Tatimi i paguar

Rrjedha neto e parase se gatshme nga A.O.

Për më shumë...

- Shiko shembullin ne faqen 542.

Pyetje



Suksese!